



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS (GLLOGOC)

Zyra e Kryetarit

01 Nr 031-50382 dt 20.11 2014



Nga : Kryetari i Komunës z. Nexhat Demaku

Për : Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA : Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogocit)
në mbledhjen e mbajtur me datë 14.11.2014

1. Vendimi për emërimin e Komisionit për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis
2. Vendimi për financimin e projektit të RFBSH "Drenasi 2014"
3. Aprovimi i Rregullorës për Kushtet dhe Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Taksi të udhëtRëve
4. Vendim për dhënien në shfrytëzim të lokalit për OJQ "QKRMT"
5. Aprovimi i Rregullorës për tatimin në Pronen e paluajtshme për vitin 2015
6. Vendim për financimin e projektit "Ekspozitë e punimeve të nxënësve për ditën ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave
7. Vendim për aprovimin e rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2014

Drenas, më datë: 20.11.2014



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)

Kuvendi i Komunës
Nr. _____ dt. _____ 2014



Nga : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- Z. Naim Bazaj



Për: Kryetarin e Komunës z. Nexhat Demakun

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt: 14.11.2014

1. Vendim për emrimin e komsionit për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis
2. Vendim për financimin e projektit RFBSH „ Drenasin 2014”
3. Aprovimi I rregullores për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit Taksi të udhëtarëve
4. Vendimi për dhënjën në shfrytezim të lokalit për OJQ „QKRMT “
5. Aprovimi I rregullores për tatimin në pronen e paluatshme për vitin 2015
6. Vendim për financimin e projektit – ekspozitë e punimeve të nxënësve lidhur me ditën nderkombtare kunder dhunes ndaj grave
7. Vendim për aprovimin e rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2014

Më dt: 19.11.2014

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT(GLLOGOC)
KUVENDI I KOMUNËS

12 Nr *400-50216* dt. *19. 11 2014*

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të ligjit nr.03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, nenit 24 Ligjit nr.03/L-025 për mbrojtje të mjedisit, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogocit) ne mbledhjen e mbajtur me dt. 14.11.2014 aprovoi këtë :

VENDIM

Për caktimin e komisionit për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis

Neni 1

Me këtë vendim caktohet komisioni për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për teritorin e Komunës së Drenasit

Neni 2

PLVM ka për qëllim definimin e prioriteteve mjedisore për periudhë të caktuar kohore për vitet 2014 - 2019

Neni 3

Me aprovimin e këtij vendimi për Planin lokal të Veprimit në Mjedis përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat paraqiten në plan dhe janë të shtjelluara në mënyrë që të kenë përmbajtjen e njëjtë duke filluar që nga identifikimi i tyre, prioriteti i problemit, pastaj përcaktimi i bartësve kyq dhe mjeteve teknike dhe financiare që do të mundësonin zgjidhjen e këtyre problemeve.

Neni 4

Hartimi i PLVM-së parashihet që të ketë lidhshmëri të ngushtë edhe me Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban të Drenasit

Neni 5

Mjetet për hartimin e këtij plani sigurohen nga donatorët e mundshëm dhe buxheti Komunal

Neni 6

Komisioni për hartimin e këtij plani është në këtë përbërje :

- Betim Berisha - Kryetar
- Haki Bekolli - Kryesues
- Milaim Hajdari – anëtar
- Hyrije Xhemajli – anëtar
- Hamdi Krasniqi – anëtar
- Shaban Dobra - anëtar
- Afrim Prokshi - anëtar
- Xhavit Nebihi - anëtar
- Vehbi Berisha - anëtar
- Riza Hajdari - anëtar
- Ragip Veseli - anëtar
- Astrit Bilalli - anëtar

Neni 7


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga Kuvendi I Komunës dhe autoriteti mbikqyres i. MAPL-sw



Kryesuesi I Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



Nr. 400-50032 dt. 18.11 2014

Në bazë të nenit 12 pika d, nenit 40 pika b, dhe c, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b. dhe c. Të Statutit të Komunës së Drenasit, rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve si dhe vendimit për buxhet të aprovuar për vitin 2014 Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 14.11.2014 aprovoi këtë:

V E N D I M
Për financimin e projektit RFBSH „Drenasi 2014”

Neni 1.

Me këtë vendim kerkohet mbështetja financiare për projektin e RFBSH „Drenasi 2014” Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për organizimin e RFBSH Drenasi 2014

Neni 2.

Projekti i RFBSH „Drenasi 2014” përkrahet me shumën prej 6.800€ mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2014

Neni 3.

Financimi – Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve ,subvencioneve dhe transfereve ,kodi ekonomik 21/85001/200.

Neni 4.

Mjetet financiare barten ne konton e RFBSH „Drenasi 2014”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2. të ketij vendimi të përciellë implementimin e projektit ,duke kërkuar nga RFBSH Drenasi 2014 që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Signature]
Naim Bazaj



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Kuvendi i Komunës**

12 Nr. 344-50040
Më dt. 18.11.2014



**RREGULLORE
PËR KUSHTET DHE KRITERET PËR USHTRIMIN
E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE**

Nentor, 2014

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c, nenit 17 paragrafi 1, pika f si dhe nenit 40 të Ligjit nr 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 32, paragrafi 5, të Ligjit nr. 04/L-179, për transportin rrugor dhe të nenit 34.6 paragrafi 1, pika a dhe f të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), 01. nr. 110 -6904 të dt. 16.09.2008, Kuvendi i Komunes ne mbledhjen e vet të mbajtur me dt. 14.11.2014 aprovoj këtë:

R R E G U L L O R E
PËR KUSHTET DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e kryerjes dhe e organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e komunës së Drenasit (Glllogocit) (në tekstin në vazhdim "komuna"), kushtet themelore dhe plotësuese që duhet plotësuar drejtuesi i taksisë dhe automjeti taksi, të drejtat dhe detyrat e drejtuesve të automjeteve për veprimtari taksi, si dhe të personave që transportohen, numri i licencave për taksi në kuadër të territorit të komunës, caktimi i stacioneve për taksi, mënyra e shfrytëzimit të tyre, rregullimi, mirëmbajtja dhe numri i automjeteve në stacionet e taksive, si dhe çështjet tjera në përputhje me Ligjin për transportin rrugor.

Neni 2

Rregullimin dhe organizimin e transportit taksi të udhëtarëve e bën Drejtoria kompetente për shërbime publike (në tekstin në vazhdim "Drejtoria"), në përputhje me nevojat për transport public.

Neni 3

Transporti taksi është transport publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtëlinjor) rrugor, për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është i njohur më parë dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit, sipas çmimoreve të shërbimeve.

Neni 4

Transporti taksi i udhëtarëve mund të kryhet vetëm me automjete me 5 (4+1) ulëse, që kanë së paku katër dyer dhe me motoçikleta një plus një(1+1)ulëse por vetem brenda qytetit.

Neni 5

- (1) Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve pa licencë.
- (2) Numrin e licencave dhe kushtet për licencim për transportuesit taksi të udhëtarëve në territorin e komunës i cakton Drejtoria, me propozim të Këshillit të Drejtorëve, kurse lejen për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve e lëshon Drejtoria kompetente për çështje të biznesit.

Neni 6

Transportin taksi të udhëtarëve mund ta ushtrojnë personat fizikë, të cilët këtë e kanë profesion të vetëm dhe operatorët juridikë, të cilat i plotësojnë kushtet e caktuara me ligj dhe me këtë rregullore.

II. KUSHTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

A. Personi fizik Neni 7

(1) Përveç kushteve ligjore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, personi fizik duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- a) të ketë patentën e shoferit për kategorinë "B",
 - b) të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
 - c) të jetë banor i komunës së Drenasit (Glllogocit),
 - d) të ketë së pakut dy (2) vjet përvojë si drejtues i automjetit,
 - e) të mos i jetë shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit taksi të udhëtarëve, më gjatë se gjashtë (6) muaj.
 - f) të ketë njohuri për territorin e komunës së Drenasit (Glllogocit),
 - g) certifikatën e mjekut me afat validiteti, sipas Ligjit nr. 02/L- 070,
 - h) pëlqimin e Drejtorisë së Inspekcionit – Inspekcionit të komunikacionit rrugor.
- (2) Dispozita e paragrafit 1, pika e të këtij neni nuk do të aplikohen nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga dita e skadimit të ndalesës.
- (3) Personi fizik mund të ushtrojë këtë veprimtari vetëm me automjetin në pronësi të tij, të cilin e drejton vet.

B. Operoret juridik Neni 8

(1) Për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, operatori juridik duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a) të jetë regjistruar për këtë lloj të transportit;
 - b) që drejtuesit e taksive të operatori t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara me nenin 7, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje;
 - c) të jetë pronar i automjeteve, të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me këtë Rregullore,
 - d) të ketë selinë në territorin e komunës së Drenasit (Glllogocit),
 - e) të ketë vendqëndrimin e vet për automjetet me të cilat ushtron veprimtarinë taksi të udhëtarëve,
 - f) të ketë sistemin e radiolidhjeve dhe
 - g) pëlqimin e Drejtorisë së Inspekcionit – Inspekcionit të komunikacionit rrugor.
- (2) Vendqëndrimi nga paragrafi 1, pika e e këtij neni është pikënisje e automjeteve për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve.

III. NDËRPRERJA E PËRKOHSHME E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 9

Drejtuesi i taksisë përkohësisht mund të ndërpresë ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, në kohën e:

- a) shfrytëzimit të pushimeve të parapara në ligjet në fuqi,
- b) aftësimin profesional ose kryerjes së funksionit publik,
- c) riparimit të automjetit me të cilin ushtron veprimtarinë e transportit taksi të udhëtarëve, në kohëzgjatje prej 15 ditëve gjatë vitit kalendarik,
- d) paraburgimit ose vuajtjes së dënimit me burg, në kohëzgjatje deri në gjashtë (6) muaj, si dhe për kohën sa zgjat procedura e hetuesisë, përkatësisht masa e ndalimit të drejtimit të automjetit.

Neni 10

- (1) Kërkesën për ndërprerjen e përkohshme të ushtrimit të veprimtarisë, nga neni 11 i kësaj rregulloreje, drejtuesi i taksisë ia parashtron drejtorisë kompetente për çështjen e biznesit, në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e paraqitjes së rrethanave nga neni paraprak.
- (2) Pas kërkesës, nga paragrafi 1 i këtij neni, drejtuesi i taksisë menjëherë detyrohet të kthejë licencën për ushtrimin e veprimtarisë, e cila do të mbetet në drejtori për at kohë sa zgjat masa e përkohshme.
- (3) Drejtuesi i taksisë, po ashtu detyrohet që të rifillojë punën në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e ndërprerjes së arsyeve për të cilat është lejuar ndërprerja e përkohshme e ushtrimit të veprimtarisë.

IV. NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 11

Drejtuesi i autotaksisë e ndërpre në veprimtarinë:

- a) më kërkesë për çregjistrim për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve,
- b) më paraqitjen e rrethanave, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, paragrafi 1, pika a deri te pika f të kësaj rregulloreje ose
- c) më rastin e vdekjes së ushtruesit të veprimtarisë.

Neni 12

Drejtuesi i autotaksisë detyrohet që, në rast të ndërprerjes së veprimtarisë (neni 9), t'i kthejë lejen për ushtrimin e kësaj veprimtarie drejtorisë kompetente për çështjen e biznesit.

Neni 13

- (1) Veprimtaria e operatorit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve ndërpritet me fshirjen nga regjistri.
- (2) Operatori detyrohet që në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, t'i kthejë licencën drejtorisë kompetente për çështjen e biznesit

V. AUTOMJETI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 14

- (1) Automjeti për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve (në tekstin e mëtejshëm “automjeti taksi”), pos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t’i plotësojë edhe këto kushte:
- a) të ketë më së shumti pesë (5) ulëse, duke llogaritur edhe ulësen e drejtuesit të automjetit,
 - b) të ketë së paku katër (4) dyer,
 - c) të ketë motorin katër taktesh, me fuqi së paku 36,8 KV,
 - d) të ketë taksimetrin në gjendje të rregullt teknike, të atestuar dhe të vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër, dhe i vendosur në atë mënyrë që shuma e parave të regjistruara të jetë e dukshme për udhëtarin, e ekuilibruar (bazhdaruar) për çdo vit,
 - e) ngrohja dhe ftohja në automjet të jenë në rregull teknikisht,
 - f) të ketë shenjën “TAXI” ose “RADIO-TAXI”, të vendosur mbi automjet dhe gjatë natës të jetë e ndriçuar,
 - g) automjeti të jetë i pastër dhe pa dëmtime,
 - h) reklamat dhe shenjat e ndryshme (nëse i ka), të mos jenë mbi sipërfaqen e xhamave në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit, si dhe xhamat të mos jenë të ngjyrosur,
 - i) të ketë aparatin kundër zjarrit, të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm,
 - j) të ketë librin e faturave të destinuar për taksi - shërbime, me kopje,
 - k) automjeti të jetë teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve dhe kontrolli teknik të bëhet çdo 6 muaj,
 - l) përveç kushteve të parapara me këtë paragraf, automjetet taksi të operatoreve duhet të jenë të ngjyrosura me ngjyrë të njëjtë.
- (2) Shenja “TAXI” dhe shenja “RADIO - TAXI”, nga paragrafi 1, pika f e këtij neni, duhet të jetë e madhësisë 500 x 120 x 80 milimetra, me ngjyrë të verdhë dhe shkronja të zeza.
- (3) Shenja përmban: emblemën e Komunës, shkrimi “TAXI” për personat fizikë dhe “RADIO TAXI” për operatorët juridikë, numrin e evidencës së automjetit taksi.
- (4) Shenjat plotësuese vendosen në anën e djathtë të xhamit të përparmë dhe në anën e majtë të xhamit të prapmë mbrojtës të automjetit.

Neni 15

Me automjet taksi nuk mund të transportohen:

- a) fëmijët nën moshën gjashtëvjeçare (6) pa përcjellës, përveç nëse prindi apo kujdestari lidh marrëveshje me shkrim me drejtuesin e taksisë, të cilit ia ka besuar fëmijën për t’u transportuar deri në vendin e caktuar,
- b) personat në ndikim të alkoolit apo drogës dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse,
- c) personat të cilët me veshmbathjen e vet do të dëmtonin apo përlyenin brendinë e automjetit,
- d) kufomat,
- e) kafshët e ngordhura,
- f) materialet: eksplozuese, radioaktive, helmuese, infektive, ato që ndizen lehtë dhe material të tjera, të cilat për shkak të vetive të veta, mund të paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, apo mund të shkaktojnë dëmtime të tjera.

Neni 16

- (1) Pronari i automjetit taksi, i cili nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve apo shenjën "TAXI", përkatësisht "RADIO - TAXI", përjashtohet nga trafiku nga inspektori i trafikut rrugor, përkatësisht nga punëtori i autorizuar i policisë, i merret librezë e qarkullimit dhe targat e automjetit, në kohëzgjatje nga 48 orësh deri në 5 (pesë) ditë. Kthimi i librezës së qarkullimit dhe targave të automjetit bëhet pas pagesës së gjobës mandatore.
- (2) Vendimi për përjashtimin e automjetit taksi nga trafiku i dorëzohet drejtuesit, aty për aty. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara për shkak të aplikimit të dispozitës nga paragrafi paraprak i këtij neni, në tërësi i bart pronari i automjetit, përkatësisht drejtuesi.
- (3) Hyrja në automjet dhe dalja e udhëtarëve nga automjeti taksi, nuk mund të bëhen në vendqëndrimet e autobusëve.
- (4) Kur drejtuesi i automjetit taksi nuk kryen transportin taksi të udhëtarëve, përkatësisht kur përdor automjetin taksi për nevoja të veta, është i obliguar që nga kulmi i automjetit të heqë shenjën "TAXI" apo "RADIO - TAXI".
- (5) Automjetet taksi, të regjistruara për transportin taksi të udhëtarëve në territorin e komunave të tjera, mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në territorin e komunës së Gillogocit, në rastin kur sjellin udhëtarë nga komunat tjera, por në kthim nuk guxojnë të marrin udhëtarë të rinj, ndërsaq vetëm mund t'i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë.
- (6) Me automjet taksi nuk mund të transportohet numër më i madh i udhëtarëve nga numri I ulëseve të regjistruara në automjet, e as që mund të vendoset më vonë numër më i madh I ulëseve nga ato të regjistruara.

VI. VENDQËNDRIMET - STACIONET E AUTOMJETEVE TAKSI

Neni 17

- (1) Vendqëndrimi i automjeteve taksi është sipërfaqe e trafikut, e destinuar për qëndrimin e automjeteve taksi gjatë punës së drejtuesve të tyre.
- (2) Vendqëndrimi i automjeteve taksi shënohet më shenjat horizontale dhe ato vertikale të trafikut. Në shenjën vertikale shënohet emri, numri i vendqëndrimit dhe numri i vendeve.
- (3) Në vendqëndrime nuk guxon të ketë më shumë automjete se që ka vende të shënuara për automjetet taksi.

Neni 18

Për mirëmbajtjen e vendqëndrimeve të automjeteve taksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut, kujdeset operatori të cilit i besohen këto punë.

Neni 19

Vendqëndrimet, numrin, mënyrën e shfrytëzimit, rregullin dhe numrin e automjeteve taksi në vendqëndrime i cakton Komisioni i caktuar nga Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me shoqatën e transportuesve "TAXI" dhe "RADIO - TAXI"

Neni 20

- (1) Në vendqëndrimet e automjeteve taksi, automjetet vendosen sipas rendit të ardhjes.
- (2) Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet të jetë pranë automjetit të vet gjatë kohës derisa qëndron në vendqëndrim të automjeteve taksi.
- (3) Drejtuesi i automjetit taksi nuk guxon të ofrojë shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit dhe të fillojë transportin jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi.
- (4) Drejtuesi i automjetit taksi mund të marrë udhëtarë jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi, në vendet ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve, vetëm më kërkesën e udhëtarit.
- (5) Drejtuesi i automjetit taksi nuk guxon të qëndrojë, e as të marrë udhëtarë, në vendqëndrimet për transportin publik të udhëtarëve (vendqëndrimet e autobusëve, në stacionet e autobusëve dhe në zonën e këtyre vendqëndrimeve, në largësi prej 50 - 100 metra nga vendqëndrimi, përkatësisht nga stacioni, në të dy anët e tij) e paraqitur me shenjë të komunikacionit.

VII. TRANSPORTI ME AUTOMJETET TAKSI

Neni 21

- (1) Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet të pranojë për transport secilin udhëtarë në kufijtë eulëseve që ka në dispozicion, si dhe bagazhin e udhëtarit në kufijtë e madhësisë dhe të fuqisë bartëse të hapësirës për bagazh, përveç udhëtarëve dhe gjësendeve nga neni 15 i kësaj rregulloreje.
- (2) Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që ndaj udhëtarëve të sillet me kujdes dhe në mënyrë korrekte.

Neni 22

Drejtuesi i automjetit taksi obligohet që transportin ta fillojë:

- a) nga vendqëndrimi,
- b) sipas thirrjes telefonike ose
- c) me radio - lidhje.

Neni 23

- (1) Transporti me automjetin taksi fillon me hyrjen e udhëtarit në automjet.
- (2) Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që, me të hyrë të udhëtarit në automjet, të aktivizojë taksimetrimin.

Neni 24

Drejtuesi i automjetit taksi detyrohet që transportin ta bëjë nëpër rrugët publike që udhëtari kërkon, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër deri në vendin ku kërkon udhëtari.

Neni 25

- (1) Drejtuesi i automjetit taksi është i detyruar që gjatë kohës së udhëtimit, të vendosë lejen për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi në automjet, në mënyrë që ajo të jetë e dukshme për udhëtarin.

- (2) Drejtuesi i automjetit taksi është i detyrohet që gjatë udhëtimit të jetë rregulluar në nivelin e duhur (i pastër, me mustaqe e mjekër të rregulluar, nëse i mban, me veshmbathje të pastër).
- (3) Drejtuesi i automjetit taksi, gjatë punës nuk mund të jetë i veshur me pantallona të shkurtra, me ndërresa pa mëngë, përkatësisht pa këmishë, dhe duhet të jetë i mbathur me këpucë, atlete (patika) apo sandale, por me çorape.

VIII. KOMPENSIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 26

- (1) Kompensimi për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve përcaktohet me çmimore të shërbimeve dhe paguhet në shumën që tregon taksimetri në vendin e arritjes së udhëtarit.
- (2) Në shumën e kompensimit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarit është llogaritur edhe transporti i bagazhit. Drejtuesi i automjetit taksi është i obliguar të japë faturën për shërbimin e kryer.
- (3) Propozimin e çmimores nga paragrafi 1 i këtij neni, e përcakton drejtoria kompetente për çështjet e biznesit, në konsultim me Shoqatën e transportuesve taksi të udhëtarëve, kurse vendimin e merr Këshilli i drejtorëve. Çmimorja duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm brenda automjetit.
- (4) Çmimi i transportit në relacionet më të gjata se 25 km, mund të kontraktohet me marrëveshje të lirë, para fillimit të transportit, pa aktivizimin e taksimetrit.

Neni 27

- (1) Në rastin e pamundësisë së kryerjes së transportit taksi të filluar, drejtuesit të automjetit i takon, si kompensim, gjysma e shumës të cilën e tregon taksimetri në momentin e ndërprerjes së transportit.
- (2) Drejtuesi i automjetit taksi obligohet që në rastin nga paragrafi paraprak, brenda mundësive, të sigurojë automjet tjetër për vazhdimin e transportit të udhëtarëve deri në vendin e caktuar nga udhëtarët.

Neni 28

- (1) Për pranimin e udhëtarëve të tjerë gjatë transportit deri te vendi i përcaktuar, vendos udhëtari, i cili ka filluar shfrytëzimin e transportit taksi me pëlqimin e drejtuesit të automjetit taksi.
- (2) Nëse udhëtari i cili është pranuar gjatë udhëtimit, vazhdon shfrytëzimin e transportit taksi edhe pas vendit të përcaktuar të udhëtarit, i cili ka filluar shfrytëzimin e transportit taksi, vazhdimi i udhëtimit deri në distancën 100 m nuk konsiderohet si fillim i shfrytëzimit të transportit taksi.

Neni 29

Nëse më shumë udhëtarë shfrytëzojnë njëkohësisht transportin taksi deri në vendin e njëjtë të përcaktuar, kompensimin për kryerjen e transportit taksi e paguajnë në mënyrë proporcionale udhëtarët që shfrytëzojnë transportin taksi.

XI. MBIKËQYRJA

Neni 30

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë drejtoria kompetente për punët e inspektionit – Inspekcioni i komunikacionit rrugor dhe policia.

X. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 31

Nëse drejtuesi i automjetit bën transportin taksi të udhëtarëve në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, do të gjobet me gjobë mandatore prej 100,00 €.

Neni 32

Me gjobë mandatore prej 100,00 € do të gjobet drejtuesi i automjetit taksi, nëse nuk vepron në kuptim të nenit 12, nenit 14, nenit 20, paragrafi 5 dhe të nenit 25.

Neni 33

- (1) Drejtuesi i automjetit taksi do të gjobet për kundërvajtje, me gjobë prej 150,00 €, nëse:
- a) bën transportin taksi të udhëtarëve në kundërshtim me dispozitat e nenit 15,
 - b) nuk gjendet në automjetin e vet, derisa ai gjendet në vendqëndrim dhe nëse nuk vendos automjetin sipas renditjes së ardhjes (neni 20, paragrafi 1 dhe 2,
 - c) ofron transport taksi jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi (neni 20, paragrafi 3, personalisht apo përmes ndërmjetësuesit,
 - d) vepron në kundërshtim me nenin 20, paragrafi 5 dhe nenin 21,
 - e) nuk aktivizon taksimetrin në momentin e hyrjes së udhëtarit në automjet,
 - f) nuk kryen transportin taksi nëpër rrugët të cilat i cakton udhëtari, përkatësisht nëpër rrugën më të shkurtër (neni 24),
 - g) kompensimin për transportin e bërë e arkëton në shumë më të lartë se shuma që tregon taksimetri (neni 26),
 - h) vepron në kundërshtim me nenin 29 të kësaj Rregulloreje.
- (2) Për kundërvajtje, nga paragrafi 1 pikat: a, b, c, d të këtij neni, do të shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh deri në një (1) vit.

Neni 34

- (1) Në rast se operatori juridik nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, nenit 13, paragrafi 2, nenit 14 dhe nenit 17, paragrafi 2, do të gjobet për kundërvajtje, me gjobë prej 500,00 €.
- (2) Për kundërvajtje, nga paragrafi paraprak, do të gjobet edhe personi përgjegjës i operatorit juridik, me gjobë prej 100,00 €.

Neni 35

Inspektori komunal i komunikacionit, nga neni 16, paragrafi 4, neni 22 dhe 27, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje, ka autorizime të shqiptojë dënimin (gjobën) mandator për kundërvajtje në shumë prej 100,00 €.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 36

Testimin e kandidatëve për njohurit për qytetin nga neni 7, paragrafi 1, pika f e bën Drejtoria kompetente për Shërbime Publike, në bashkëpunim me inspektorët e komunikacionit rrugor.

Neni 37

Procedura, sipas kërkesës për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, që ka filluar e nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 38


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve.

Neni 39

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në Fëb – faqën e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT (GLLOGOC)
KUVENDI I KOMUNES

Nr 360-S/45 dt. 19.11.2014

Në bazë të nenit 12 pika (d), nenit 14.2 si dhe nenit 40 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt: 14.11.2014 aprovoj kërë:


VENDIM

Për dhënjën në shfrytëzim të perkohshëm të objektit banesor të komunës I cili gjindet në Bllokun e VIII-të” Llamella A” në Drenas-QKRMT

- I. Objekti banesor i cili është në pronësi të Komunës gjindet në Bllokun e VIII-të-“ Lamela A” në Drenas, në Bodrum nr.3b në sipërfaqe prej 88.22m², i IPET në shfrytëzim të perkohshëm me qira “Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mijetuarëve të Torturës” -Degës Drenas
- II. kohëzgjatja e shfrytëzimit të këtij objekti nga Kuvendi I komunës u caktua 10(dhjetë)vite me mundësi vazhdimi,veprimtaria dhe aktivitetet që do të zhvillohen nga shoqata ka të bëjë me aftësimin profesional te grupit të grave per rrobaqepsi dhe pasticeri,per qera dhe obligime tjera me detajisht do të përcaktohet në bazë të Kontratës mbi dhëniën me qera të objektit të përshkruar në pikën një të këtij vendimi, por ne momentin e mos respektimit te vendimit dhe zbatimit te kontrates nga QKRMT Komuna mund të tërhiqet nga kjo kontratë në çdo kohë duke respektuar afatin e terheqjes me njoftim paraprak prej 30 ditësh.
- III. Meqë objekti i dhënë perkohesisht në shfrytëzim nuk i plotëson kushtet për punë për ushtrimin e veprimtarisë së vet, shfrytëzuesi i këtij objekti merr përsipër që renovimin e këtij objekti t’a bëjë vetë pas marrjes së lejës nga Organi Komunal, shpenzimet që do të krijohen për renovim të këtij objekti do të zbriten në emër të qerasë e cila do t’i faturohet për çdo muaj nga Komuna.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës.
- V. Me këtë vendim do të njoftohen :Drejtoratet e Komunës së Drenasit, QKRMT të Kosovës – Dega në Drenas, dhe një mbetet për evidencë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës

Kryesuesi I Kuvendit të Komunës




Naim Bazaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi I Komunës

Nr. 952-49741

Drenas, më 17.11. 2014

Në vështrim të nenit 12 dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në bazë të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/ L – 204 ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme nr. 04/ L – 100, neni 7 , si dhe në bazë të nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datën 14.11.2014 aprovoi këtë

RREGULLORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2015

Neni 1

1.1. Duke u mbështetur në nenin 6 të Ligjit nr.03/L – 204 , Tatimi mbi Pronën e Paluajtshme.

Baza tatimore do të caktohet si vijon:

Sipas zonave tatimore në bazë të vlerës së tregut në m2

Përshkrimi i pronës	Zona e I-rë	Zona e IA	Zona e IB	Zona e II-të	Zona e IIA	Zona e III-të	Zona e IV-të
Pronat rezidenciale Banesat	350	340	330	320			
Pronat rezidenciale Shtëpitë	300	280	260	250	240	200	150
Pronat Komeriale	650	600	550	500	450	400	350
Pronat industrial	360	360	360	360	360	360	360
Pronat Bujqësore	100	100	100	100	100	100	100
Pronat e papërfunduara	120	112	104	100	96	80	60
Depotë-Magazinat	360	330	300	270	240	210	180
Magazinat Komeriale	390	360	330	300	270	240	210
Pronat Komeriale të pashfrytëz.	455	420	385	350	315	280	245
Fushat sportive dhe pishinat	200	200	200	200	200	200	200
Garazhat	100	100	100	100	100	100	100
Pronat e braktisura	50	50	50	50	50	50	50

1.2. Në bazë të Udhëzimit Administrativ, nr.03/2011 për mbledhjen dhe rexhistrimin e informative për pronën e paluajtshme përcaktohet koeficienti i vlerësimit për objektet ndërtimore.

Neni 2.

2.1. Duke u bazuar në vendin ku ndodhet prona, komisioni mbi vlerësimin e zonave tatimore, në komunën e Drenasit, në bazë të shqyrtimit të kontratave të shitëblerjeve dhe parametrave tjerë, ka nxjerrë vlerën e tregut për të gjitha llojet e objekteve, dhe i ka përcaktuar katër zona dhe tre nënzona të vlerësimit

Neni 3.

3.1. Teritori i komunës së Drenasit, ndahët në katër zona dhe tre nënzona tatimore.

Zona e I

Zona e Ia

Zona e Ib

Zona e II

Zona e IIa

Zona e III

Zona e IV

Zona e parë – I.

1.1. Në këtë zonë hyjnë të gjitha objektët ndërtimore që gjenden në qendër të Drenasit.

Fillon nga rrethrotullimi, pra nga rruga „Skenderbeu” dhe vazhdon deri te Ndërtesa e KFOR-it.

1.2. Sheshi „ Fehmi Lladrovci”

1.3. Rrugët „14 Qershori”, „Bedri Shala”, „Hasan Prishtina”, „Rasim Kiqina”, „Emin Duraku”, „Ganimete Terbeshi”, Hivzi Sylejmani”, „Zejtaret”, „Fehmi dhe Xhevë Lladrovci”, si dhe

1.4. Objektet ndërtimore që gjenden në të dy anët e rrugës „Shëndeti” dhe shkon deri te rrethrotullimi .

Zona e parë-Ia.

1.1a. Në këtë zone hyjnë të gjitha objektet të cilat gjenden jashtë qendrës së Drenasit e që janë mbrënda lagjeve dhe që kanë dalje në rrugë kryesore në largësi prej më shumë se 50 m.

1.2. Rruga "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci" nga tregu i gjelbërt dhe vazhdon deri në dalje në rrugën kryesore që shkon për Skenderaj, si dhe objektet deri te sh.f."Halil Bajraktari; pra rruga që shkon për Dodonë (Gradicë).

1.3. Objektet të cilat gjenden në qendër të Bushatit (Komoranit) e që fillojnë prej para udhëkryqit Prishtinë-Pejë dhe Bushat (Komoran) – Drenas e vazhdon deri te Udhëkryqi ku fillon rruga Nikaj (Nekoc).

1.4. Këtu hyjnë objektet që gjenden në të dy anët e rrugës Bushat (Komoran) – Skenderaj, që fillon nga ura e Lumit Drenica dhe vazhdon deri te Njisiti i Zjarrfikësve.

1.5. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugët "Feronikeli" që fillon nga stacioni i trenit dhe vazhdon deri te porta e Feronikelit.

Zona e parë- Ib.

1.1. Në këtë zonë hyjnë të gjitha ato objekte të cilat gjenden ne rrugën "Skënderbeu" e që fillon ndertesës se Gjykatës Komunale, në të dy anët e kësaj rruge.

1.2. Objektet që fillojnë prej rrugës së "Feronikelit" te Lagjja Malaj dhe vazhdon deri te rruga që ka dalje në rrugën, "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci", ose mbi rrugën e gjelbërt.

1.3. Objektet të cilat fillojnë prej rrugës " Feronikeli" te lagjja Malaj dhe vazhdon në drejtim të rrugës që ka dalje në rrugën Drenas_ Dodonë (Gradicë)..

1.4. Poashtu në këtë zonë hyjnë të gjitha ato objekte të cilat gjenden në qendër të Drenasit por që kanë dalje në rrugën kryesore.

1.5. Në këtë zonë, gjithashtu hyjnë edhe të gjitha ato objekte të cilat janë në qendër të Komoranit (Bushatit) por që nuk kanë dalje në rrugën kryesore.

Zona e dytë- II.

2.1. Në këtë zonë hyjnë të gjitha ato objekte të cilat gjenden ne Lagjën e Feronikelit,

2.2. Pokleku I Ri.

2.3. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas – Bushat e që fillon nga ura mbi lumin Drenica dhe vazhdon deri te perfundimi i zonës së Zabelit të Ulët.

2.4. Lagja e Re e (Bushatit) Komoranit.

2.5. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës magjistrale Prishtinë – Pejë

2.6. Qendra e Biznesit në Korroticë të Epërme.

2.7. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Bushat – Nikaj (Nekoc) deri të rruga që hyn për mulli.

2.8. Rruga që shkon për te Lagja e Re në Bushat e deri në dalje në rrugën magjistrale Prishtinë Pejë.

2.9. Objektet ndërtimore që gjenden përgjatë rrugës. Drenas – Arllat – Malishevë.

2.10. Objektet të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas-Skenderaj, që fillon nga Njisiti i Zjarrfikësve dhe vazhdon deri në përfundim të teritorit të komunës së Drenasit.

2.11. Në këtë zonë hyjnë ato objekte të cilat gjenden në rrugën Drenas-Shtrubullovë që fillon nga rrethrotullimi dhe vazhdon deri të varrezat e fshatit Shtrubullovë.

2.12. Objektet përgjatë rrugës “Nëna Terezë”, që fillon nga rruga e “Jasharajve” dhe vazhdon deri te Ura e Balcëve dhe rruga që shkon dhe takohët me rrugën magjistrale Drenas- Skenderaj.

Zona e dytë – II a.

2.1. Në këtë zonë hyjnë të gjitha ato objekte që gjenden në lagjën e Xhamisë.

2.2. Lagja Qorri (afër Feronikelit), që nuk ka dalje nërrugën kryesore.

2.3. Objektet që gjenden përgjatë rrugës Drenas- Shtrubullovë e që fillon nga varrezat e fshatit Shtubullovë dhe vazhdon deri në përfundim të kësaj zone kadastrale.

2.4. Pastaj në këtë zonë hyjnë edhe objektet të cilat gjenden në mbrëndi të fshatit e që nuk kanë qasje në rrugë kryesore prej 100 m e më tepër si ato në Korroticë të Ulët, Qikatovë e Re, Zabel i Ulët, Shtrubullovë.

2.5. Kompleksi i banesave në Qikatovë të Re.

2.6. Objektet që gjenden në rrugën Drenas-Gradicë (Dodonë) e cila fillon nga shkolla fillore "Halil Bajraktari" dhe përgjatë dy anëve të rrugës deri në përfundim të rrugës së asfaltuar.

2.7. Objektet që gjenden në rrugën Drenas- Krajkovë, që fillon nga hekurudha (e trenit) dhe vazhdon deri te shkolla fillore në Krajkovë.

2.8. Objektet ndërtimore të cilat gjenden në të dy anët e rrugës Drenas_ Abri dhe fillon nga Ura e Lumit (lagja e Balcëve) dhe përfundon te shkolla fillore e Baicës.

2.9. Në këtë zonë hyjnë edhe objektet të cilat gjenden përgjatë rrugës së asfaltuar Drenas- Dritan.

Zona e tretë – III.

3.1. Në këtë zonë hyjnë të gjitha objektet ndërtimore të cilat gjenden në lagjet tjera jashtë qendrës së Bushatit në largësi mbi 50 m nga rruga kryesore.

3.2. Kizhareka (Ndrekaj) , Nekoci (Nikaj), Zabeli I Eper, Fushtica e Ulet, Krajkova, Damaneku, Korotica e Epërme, Gllobari (Bletari), Qikatovë e Vjetër dhe Pokleku I Vjetër.

Zona e katërt- IV.

4.1..Në këtë zonë hyjnë të gjitha ato objekte ndërtimore të cilat gjenden në fshatrat si: Arllat, Llapushnik, Negroc (Fatos), Nënkala (Vuqak) Fortesë ,(Vërboc) Rezistencë, (Baicë) Abri, Polluzhë, Terstenik, Kodër, (Shtuticë) Likoshan, Dodonë (Gradicë), Shpat (Godanc), Shkabë (Gllanasellë), Dritan (Dobroshevc), Malësi (Malësi), Flamuras (Sankoc), Fushticë e Eperme dhe Grykas (Tërdec).

Vlenë të përmendët se tek objektet industriale nuk ka dallim zonash pasi që vlera e këtyre objekteve nuk ndryshon në bazë të zonave tatimore, por është e njëjtë, prandaj të gjitha këto objekte tatimohen njëjtë në të gjitha zonat tatimore, pra vlera e tyre, nuk ndryshon varësisht nga zona në të cilën gjenden. Sipas kësaj vlenë për NSHPR, " Neëco Feronikeli" L.L.C. NSHPR "Trasing Group", NSH "Mineral", L.L.C si dhe të gjitha ato objekte që regjistrohen si objekte industriale dhe ushtrojnë veprimtari komerciale poashtu edhe të gjitha fushat sportive dhe pishinat.

Neni 4.

4.1. Ne pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-204 për Tatimin mbi pronën e paluajtshme, normat tatimore për vitin tatimor 2015 në Komunën e Drenasit janë si vijon:

KATEGORIA E PRONËS	NORMAT TATIMORE NË %
Pronat Rezidenciale Banesat	0.15%
Pronat Rezidenciale Shtepitë	0.15%
Pronat Komerikale	0.16%
Pronat industriale	0.20%
Pronat bujqesore	0.15%
Pronat e Paperfunduara	0.15%
Depotë/magazinat	0.20%
Magazinat komerikale	0.16%
Pronat komerciale te pa shfrytezuara	0.16%
Fushat sportive dhe pishinat	0.16%
Garazhat	0.15%
Pronat e braktisura	0.15%

Neni 5.

5.1. Pronat të cilat lirohën nga tatimi në pronë në bazë të Ligjit nr. 03/L-204, neni 8, lirohën edhe ne komunën e Drenasit.

Neni 6.

6.1. Shtryerja e pageses se tatimit në pronë, në kushte të veqanta, mund të bëhet konform nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-204.

Neni 7.

7.1. Në pajtim me nenin 22 të Ligjit 03/ L-204, për Tatimin në Pronën e paluajtshme, dhe Udhëzimit Administrativ, nr. 05/2011 neni 1. Kryetari i Komunës emron Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve të paknaqur për vitin aktual tatimor.

Neni 8.


8.1. Ligji nr. 03/ L-204 për Tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, rregullojnë të gjitha qështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë, e që nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

Neni 9.

9.1. Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, kurse aplikohet nga **01.01.2015**.



KRYESUESI I KUVENDIT


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 400-49818 dt 17.11 2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të ligjit nr.03/L-40 për vetëqeverisje lokale, nenit 4 germa (b) e Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 8.2 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të miratuar më dt.29/06/2011 nga Kuvendi i Komunës Drenas – sit 01Nr.031-6566, dt.30/06/2011 pastaj Buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas për vitin 2014, bazuar në kërkesën dhe projektin e grupit të grave asambleiste të Kuvendit të Komunes së Drenasit, Kuvendi i Komunes së Drenasit në mbledhjen e vetë të mbajtur me dt.14.11.2014 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për mbështetje me mjete financiare për projektin e ekspozites se punimeve të nxënësve lidhur me ditën nderkombtare kunder dhunes ndaj grave, projekt i punuar nga grupi i grave asambleiste te komunës se Drenasit.
- II. Vlera për ndihmë financiare është në shumën prej 3,020.00(tremijëenjëzet) €uro.
- III. Mjetet financiare për realizimin e kësaj kërkesë , lejohen nga subvencionet
- IV. Mjetet financiare barten përmes Kontos Bankare
- V. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kuvendit

Nr. 01-400-49610

Drenas, me 14.11.2014

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë me datën 14.11.2014 miratoi këtë;

VENDIM PËR APROVIMIN E RITJËS SË TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2014

Neni 1.

Me këtë vendim aprohet, rritja e të hyrave vetanake për vitin 2014.

Neni 2.

Rritja e të hyrave vetanake për vitin 2014 aprohet në shumë prej: 182,545€ dhe për këtë shumë do të rritet Buxheti i Komunës për vitin 2014.

Neni 3.

Shuma e rritjes së të hyrave vetanake të përmendur në nenin 2 të këtij Vendimi do të realizohet në Sektorin e Administratës.

Neni 4.

Mjetët e rritura dhe të aprovuara nga Kuvendi i Komunës për vitin 2014 do të shpenzohen në këto programe dhe nënprograme buxhetore sipas këtyre kategorive të shpenzimeve:

I. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime:

- | | |
|--|-------------------|
| 1. Qendra për Punë Sociale në shumë prej: | 10,000 € |
| 2. Drejtorati për Shëndetësi – Administrata në shumë prej: | 2,500 € |
| 3. Drejtorati për Buxhet dhe Financa, në shumë prej: | 3,000 € |
| 4. Drejtorati për Arsim – Administrata në shumë prej: | 117,545 € |
| Gjithsej : Mallra dhe Shërbime: | 133,045 €. |

II. Shpenzimet e Shërbimeve Komunale:

1. Drejtorati për Administratë dhe Personel, në shumë prej:.....15,000 €
 2. Drejtorati për Shëndetësi – Administrata në shumë prej:.....5,000 €
 3. Drejtorati për Shërbime Publike, në shumë prej:.....5,000 €
- Gjithsej Shërbime Komunale:..... 25,000 €.**

III. Subvencione dhe Transfer;

1. Drejtorati për Arsim – Administrata , në shumë prej:.....4,500 €
 2. Drejtorati për Shëndetësi – Administrata në shumë prej:.....5,000 €
 3. Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, në shumë prej:..... 15,000 €
- Gjithsej Subvencione:..... 24,500 €**

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi, ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, dhe për aplikimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.



KRYESUSI I KUVENDIT

Naim Bazaj
Naim Bazaj